

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE Departamenti për Krime të Rënda në Gjakovë, me gjyqtarin Gëzim Pozhegu – kryetari i trupit gjykues me pjesëmarrjen e sekretares juridike Arbënore Basha, lidhur me çështjen penale kundër të akuzuarit A. A., Komuna e Pejës, për shkak të veprës penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 pika 1.1 e KPRK-së dhe veprës penale: Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, duke vendosur për pranimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë sipas propozimit të Prokurorisë Themelore – Departamenti për Krime të Rënda në Gjakovë PP/I.nr. 27/2016 të datë 11.05.2016, në seancën e shqyrtimit gjyqësor publik për pranimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, të mbajtur në praninë e Prokurorit të shtetit të Prokurorisë Themelore –Departamenti për Krime të Rënda në Gjakovë Ali Uka, të akuzuarit A. A. si dhe mbrojtësi të tij avokati A. A. nga Gjakova, me datë 21.12.2016, publikisht shpalli këtë :

A K T G J Y K I M

I akuzuari :

A. A. nga Komuna e Pejës, ku dhe tani banon, nga i ati A. dhe ëma Rr., e lindura A., i lindur me dt.... K. e Pejës, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i 1 fëmije, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, kinse i pa dënuar me parë.

Ë S H T Ë F A J T O R

Për shkak se :

I. Me datën 23.02.2016 rreth orës 02:00 minuta, në fshatin X., K. e Rahovecit, pikërisht në restorantin “D.”, me dashje i ka shkaktuar lëndim të lehtë trupor të dëmtuarit B. K. nga fshati X., K. e Rahovecit, në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje dhe konflikti me stafin e restorantit të një dite më parë, për shkaqe të panjohura, i pandehuri A. shkon me veturën e tipit Golf V, ngjyrë hiri dhe aty në parkingun e restoranti ndal veturën, dhe me të dal nga vetura nxjerrë nga brezi revolen e tipit “Sigsauer”, kalibër 9 mm dhe nga një largësi rreth 3-4 metra shtënë 2-3 herë me te në drejtim të këmbëve të dëmtuarit B., ashtu që me një të shtënë e qëllon në këmbën e djathë, në pjesën e mbi gjurit, nga ana anësore e që me këtë rast i shkakton lëndim të lehtë trupor me pasoja të përkohshme për shëndetin, të konstatuara në raportin mjeko-ligjor Dr. M. G., ashtu që i dëmtuari B. dërgohet në qendrën emergjencës në Rahovec e më pas në Spitalin Regjional “Isa Grezda” në Gjakovë, për

ofrimin e ndihmës mjekësore, ndërsa me datë 25.02.2016 i pandehuri A. arrestohet nga ana e policisë.

- me çka ka kryer veprën penale të lëndimit të lehtë trupor nga neni 188 par. 1, pika 1.1. e KPRK-së.

II. Më parë ka siguruar dhe gjer më dt. 25.02.2016 pa autorizim ka poseduar armën në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët të tilla dhe atë një revole e tipit "Sigsauer" , me numër serik A#1019568, e kalibrit 9 mm, një karikator dhe 6 fishekë të të njëjtit kalibër, në atë mënyrë që ditën kritike i pandehuri A. A., të njëjtën e ka përdorur në mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e I-rë të kësaj aktakuze duke i shkaktuar lëndim të lehtë trupor me pasoja të përkohshme për shëndetin, të dëmtuarit B. K. nga fshati X.,K. Rahovec, e të cilën armë policia e konfiskon me rastin e arrestimit të të njëjtit.

- me çka ka kryer veprën penale : mbajtja në pronësi, kontroll, posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KPRK-së.

Andaj, gjykata me aplikimin e neneve 6, 7, 17, 41, 43, 45, 46, 73, 75 e 76, 83 nenit 188 par. 1, pika 1.1, të KPRK-së, lidhur me nenin 69 par.1, nenit 374 par.1 dhe 3 të KPRK-së si dhe neneve 233, 359 par.2, 365, 366, 450 dhe 463 të KPPK-së :

Të akuzuarin, për veprën penale nga neni 188 par. 1, pika 1.1 të KPRK-së, gjykata e:

G J Y K O N

ME DËNIM ME BURGIM, NË KOHËZGJATJE PREJ TETË (8) MUAJ, duke llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim nga data 25.02.2016 gjerë më 04.03.2016 gjersa nga data 04.03.2016 e gjerë më dt. 03.05.2016 nën masën e arrestit shtëpiak.

kështu që në bazë të nenit 51 par. 1 dhe 2 të KPRK-së

I shqiptohet

DËNIM ME KUSHT

Dënimi me burgim në kohëzgjatje prej tetë (8) muajve, që i është shqiptuar të akuzuarit A. A. nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari A. A. në afat prej një (1) viti nuk kryen vepër te re penale.

Për veprën penale nga neni 374 par.1 të KPRK-së, e gjykon :

ME DËNIM ME GJOBË NË SHUMË PREJ GJASHTËQINDË (600) EURO

Nëse dënimi me gjobë nuk paguhet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, i njëjti shndërrohet në dënim me burg në kohëzgjatje prej tridhjetë (30) ditësh, duke llogaritur 20,00 €, për një (1) ditë burgim.

Konform nenit 374 par. 3 lidhur me nenin 69 par.1 të KPRK-së shqiptohet dënimi plotësues i marrjes së një revoleje të tipit "Sigsauer", me numër serik A#1019568, kalibër 9 mm, një karikator dhe 6 fishekë të të njëjtit kalibër, të cilat ishin objekte të veprës penale apo është kryer vepra penale të konfiskohen.

Në kuptim të nenit 450 par.4 të KPPK-së, i pandehuri obligohet që të paguajë shpenzimet procedurale penale në shumë prej 50 euro si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 50 euro gjithsej 100 euro, e cila shumë duhet paguar në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.

Duke u bazuar në nenin 463 par.2 të KPPK-së, pala e dëmtuar udhëzohet që kërkesën pasurore juridike të realizoi në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore – Departamenti për krime të rënda në Gjakovë, ka ngritur aktakuzën PP/I.nr. 27/2016 të datë 12.05.2016, kundër të akuzuarit A. A., Komuna e Pejës, për shkak të veprës penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 pika 1.1 e KPRK-së dhe veprës penale: Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Po ashtu Prokuroria Themelore DKR në Gjakovë ka parashtruar kërkesën PP/I.nr. 27/2016, me datë 11.05.2016, me të cilën i ka propozuar kësaj Gjykate që këtë çështje ta zgjidhë me marrëveshje për pranimin e fajësisë.

Gjykata shqyrtimin gjyqësor për vendosjen mbi propozimin për pranimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë e ka mbajtur me datën 21.12.2016, ku kanë qenë prezentë Prokurori i shtetit Ali Uka, i akuzuari A. A. si dhe mbrojtësi të tij avokati A. A. nga Gjakova.

Gjykata gjatë seancës dëgjimore të shqyrtimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë ka dëgjuar të akuzuarin, mbrojtësin e tij si dhe përfaqësuesin e Prokurorisë Themelore në Gjakovë DKR, Prokurorin e shtetit Ali Uka.

Prokurori i shtetit ka deklaruar se: në GjTH DKR në Gjakovë kemi sjelle një marrëveshje për pranimin e fajësisë e arritur në mes të Prokurorit të shtetit dhe këtu të akuzuarit A. A. dhe atë sipas marrëveshjes PP/I.nr.27/2016 dt. 11.05.2016 si dhe mbrojtësit të akuzuarit av. A. A. nga Gjakova, e në të cilën marrëveshje janë përcaktuar kushtet si dhe lloji i dënimit për të cilën marrëveshje është njoftuar edhe kjo Gjykatë, si dhe vet i akuzuari i cili palë është me këtë marrëveshje. Andaj përveç kushteve të përcaktuara në këtë marrëveshje e për të cilat janë njoftuar i akuzuari dhe mbrojtësi i tij, të cilët njëkohësisht janë akorduar me këtë marrëveshje, ne si prokurori përkatësisht unë si Prokuror i çështjes deklaroj se i propozoj gjykatës që kjo marrëveshje të aprovohet dhe njëkohësisht të jetë pjesë përbërëse e shkresave të lëndës.

Lidhur me këtë marrëveshje si dhe kushtet të cilat janë përcaktuar mbi lartësinë si dhe llojin e dënimit, ne si Prokurori kemi propozuar që ndaj të akuzuarit A. A. për veprën penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 pika 1.1 e KPRK-së, të jetë dënimi me burgim nga gjashtë (6) muaj e gjer nëntë (9) muaj, me kusht që ky dënim të mos ekzekutohet nëse në afatin prej një (1) viti gjer në një (1) vit e gjysmë të mos kryejë vepër të re penale, gjersa për veprën penale mbajtja në pronësi kontroll, posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KPRK-së të jetë në mes 500,00 € e gjer në 800,00 €.

Po ashtu në marrëveshje është cekur se të akuzuarit ti shqiptohet dënimi plotësues ti konfiskohet arma dhe atë konform nenit 374 par.3 të KPRK-së të bëhet konfiskimi i armës te përshkruar si në dispozitivin e aktakuzës.

Për të gjitha këto kushte në marrëveshje është arritur pajtimi i plotë në mes të Prokurorit të shtetit, të akuzuarit A. A. dhe mbrojtësit të tij av. A. A. nga Gjakova.

Mbrojtësi i të akuzuarit A. A., av. A. A. nga Gjakova, ka deklaruar se: Përderisa ishte në zhvillim e sipër procedura e hetimit tek prokurori i çështjes, me iniciativën e të akuzuarit A. gjeqësisht se me 11.05.2016 në orën 10:10/h është paraqitur në zyrën time dhe ka kërkuar shprehimisht që prokurorit të çështjes ti parashtrijë kërkesë për negociimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, gjë të cilën e kam parashtruar me dt. 11.05.2016, i akuzuari është proceduar nga prokurori i çështjes dhe së fundi në praninë time është arritur marrëveshja PP/I.nr.27/2016 me datë 11.05.2016, dhe është pranuar nga i akuzuari fajësia, pastaj në fund të negociimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, po ashtu është arritur marrëveshja edhe për lartësinë e dënimit. Meqenëse i akuzuari ka qenë i njoftuar përkitazi me pasojat dhe benefite që ka pranimi i fajësisë, duke qenë se këtë e ka shprehur lirshëm, pa qenë i ndikuar për të vepruar kështu, e meqë pranimi i fajësisë mbështet në faktet që përmban akuza dhe provat e bashkangjitura të njëjtës është arritur marrëveshja për pranimin e fajësisë e cila është nënshkruar dhe prokurori i çështjes ka dhënë nga një ekzemplar mbrojtësit të tij. Pasi që dëgjuam në fjalën hyrëse të prokurorit propozimin, për arsyet që ceka më lartë atëherë i propozoj gjykatës që në kuptim të nenit 233 par.21 të KPPK-së ta pranojë pranimin e fajësisë të mbrojturit tim A. A.

Propozoj gjykatës që me rastin e caktimit të dënimit, të zbatojë kufijtë minimal të sanksionit duke pasur parasysh sidomos rrethanat e subsumuara në dispozitën e nenit 74 par.3, nën paragrafët në vijim të KPRK-së.

Lidhur me propozimin e prokurorit për dënimin plotësues konfiskimin e armës, e cila është përdorur e cila tani prokurori ceku se rastësisht është bërë gabim teknik, konsiderojë se e njëjta mund të shqiptohet edhe nga Gjykata meqenëse është e paraparë me KPRK-në dhe gjithashtu duke parur parasysh në këto raste, armët e përdorura nuk kthehen.

I akuzuari A. A., deklaroi se ne tërësi ngel pranë deklaramëve që i parashtrioi mbrojtësi i tij av. A. A. dhe nuk ka çka te shtoi.

Gjykata pas dëgjimit të pretendimeve të prokurorit, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, lidhur me marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë ka konstatuar se i akuzuari A. A., ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ky pranim është bërë në baza vullnetare, pas konsultimeve të nevojshme me mbrojtësin e tij, i akuzuari nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, pranimi i fajësisë mbështetet në fakte dhe prova të cilat janë paraqitur në aktakuzë dhe janë pranuar edhe nga vet i akuzuari. Po ashtu gjykata ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë për hudhjen e aktakuzës, apo atë pushimit të procedurës penale të parapara nga neni 248 par.3 të KPPK-së.

Gjykata gjendjen faktike të përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi e ka vërtetuar jo vetëm nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit por edhe nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, e për të cilat prova mbrojtja nuk ka pasur kundërshtime, siç janë : raporti i oficerit policor Xh. K. me nr.2016-EB-61 i datës 32.02.2016, tri raportet përcjellëse me numër dhe datë të njëjtë, raporti informues nga polici A. K., me numër të njëjtë i datës 26.02.2016, lista e dëshmimeve me numër të njëjtë i datës 23.02.2016, fotot e armës së konfiskuar, fotot e vendit të ngjarjes si dhe skica me legjendë, raporti mbi natyrën e lëndimeve të dëmtuarit B. K. nga eksperti mjeko ligjor Dr. M. G., po ashtu.

Andaj, Gjykata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha elementet qenësore të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të pranojë fajësinë e të akuzuarit dhe të akuzuarin e shpallë fajtor dhe ta dënojë në bazë të ligjit.

Gjatë seancës për caktimin e dënimit Prokurori i çështjes ka deklaruar se mbetet pranë dënimit të rekomanduar në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë të paraparë në faqen 1 dhe 2 të marrëveshjes, ku është propozuar që dënimi për veprën penale nga neni 188 par.1 pika 1.1 e KPRK-së të jetë dënim me burgim në kohëzgjatje nga gjashtë (6) muaj gjer në nëntë (9) muaj, me kusht që ky dënim të mos ekzekutohet nëse në afatin prej një (1) vit e gjysëm të mos kryejë vepër të re penale, ndërsa për veprën penale : Mbjajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së të jetë dënim me gjobë në lartësi prej pesëqind (500) € gjer në tetëqind (800) €. Si dhe konform nenit 374

par.3 të KPK-së të bëhet konfiskimi i një revoleje të tipit "Sigsauer" , kalibër 9 mm, me numër serik A#1019568, kalibr 9 mm, një karikator dhe 6 fishekë të të njëjtit kalibër.

Gjykata duke vendosur mbi sanksionin penal juridik të propozuar në marrëveshje ka vlerësuar të gjitha rrethanat konform nenit 73, 75 par.1 pika 1.3 dhe nenit 76 të KPRK-së që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin gjeti pranimin e fajësisë nga ana e tij në të gjitha fazat e procedurës penale, pendimin e tij për veprën e kryer, qëndrimin e tij korrekt gjatë gjykimit, është mbajtes i vetëm i familjes, andaj të njëjtit i ka shqiptuar dënimin në kuadër të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë duke shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej tetë (8) muajve duke llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim, me kusht që ky dënim të mos ekzekutohet nëse në afatin prej një (1) viti të mos kryejë vepër të re penale, si dhe dënim me gjobë në shumë prej gjashtëqind (600) Euro, me shpresë dhe bindje se dënimi i shqiptuar do të arrijë qëllimin e dënimit të paraparë me dispozitat e nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi konfiskimin e revoles së tipit "Sigsauer", me numër serik A#1019568, kalibër 9 mm, një karikator dhe 6 fishekë të të njëjtit kalibër është marrë në pajtim me nenin 69 par.1 lidhur me nenin 374 par.3 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurës penale dhe në emër të paushallit gjyqësor bazohet në dispozitat e nenit 450 par.3 të KPPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 365 par.1 të KPPK-së është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE - Departamenti për Krime të rënda në Gjakovë,
PKr.nr. 63/16, datë 21.12.2016**

Sekretarja juridike,

Kryetari trupit gjykues-Gjyqtari,

Arbënore Basha

Gëzim Pozhegu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë, nëpërmjet kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të aktgjykimit.